

PROCESVERBAL 25/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 7 (shtatë) për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 25.07.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit "Ballkani" me seli në Suharekë;**
3. **Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor 2023;**
4. **Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - z.Reshat Reshitaj, a është bërë ndryshimi në sistem te anëtarët e Komuniteteve?

Reshat Reshitaj - askush nuk e ka dërgu emailin.

Kryesuesi - të gjithë ata që kanë email adresa,ti shkruajnë në listë të nëshkrimeve dhe ata që s'kanë email, ta shkruajnë numrin e telefonit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit "Ballkani" me seli në Suharekë;

Avni Bytyqi - klubi i futbollit "Ballkani" ka bërë kërkesë për ti ndihmuar për shkak se i ka disa aktivitete kohëve të fundit dhe Kryetari i Komunës në bashkëpunim me këshillat e grupeve parlamentare të subjekteve politike kanë vendosur që ta dërgojnë në Kuvend dhe ti ndihmoj në vlerë prej 40.000 €.

Nazim Shabanaj - e përkrahi dhe i uroj suksese.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor 2023;

Avni Bytyqi - në kuadër të planit të veprimit është parapa që KKS në vitin 2023 ti mbaj së paku 6 takime. Ne në gjashtë mujorin e parë i kemi mbajtur tre takime ku kemi diskutu tema të ndryshme. Çështja e sigurisë është e kënaqshme,me disa sfida dhe probleme që paraqiten kohë pas kohe.Çështja e vjedhjeve, çështja e rrezikimit të trafikut është në rënie e sipër. Çështja e zbulueshmërisë së veprave kriminale është në zbulueshmëri në krahasim me vitet e mëparshme.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4.Të ndryshme;

Kryesuesi - është informacion për të gjithë por më shumë për Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian.

Drejtorja e Shëndetësisë ka shpall konkurs për 10 banesa për bonos banim dhe nëse keni mundësi edhe ju të informoni në teren ndonjë familje e cila i ka kushtet e vështira për banim ose nuk ka fare banim.

Avni Bytyqi - Një numër i madh i qytetarëve në Komunën e Suharekës kanë nevojë me i ndihmu. Bonus banimi ka të bëjë me ata të cilët janë me qera dhe që e kanë gjendjen e vështirë, andaj Komuna është e gatshme ti subvencionojë me 50 % të qerasë.

Takimi përfundoi: 09:10